



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

# **RREGULLORE E PUNËS SË KOMISIONIT TË ANKESAVE DHE ARBITRAZHIT TË FBK-SË**

**23.03.2026, Prishtinë**



Në bazë të nenit 20, alineja 1.5. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Kuvendi i FBK-së në mbledhjen e vet të mbajtur më 23.03.2026, miraton këtë:

## **RREGULLORE E PUNËS SË KOMISIONIT TË ANKESAVE DHE ARBITRAZHIT TË FBK-SË**

### **NENI 1 - Qëllimi i Rregullores**

- 1.** Me këtë rregullore, rregullohen statusi dhe procedura pranë Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm 'KAA').
- 2.** Selia e KAA është në Prishtinë, në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme FBK).

### **NENI 2 - Mandati**

Komisionin e Ankesave dhe Arbitrazhit e zgjedh dhe e shkarkon Kuvendi i FBK-së. Mandati i Komisionit zgjatë 4 vite.

### **NENI 3 - Përbërja**

Komisioni përbëhet prej tre (3) anëtarëve, Kryetari dhe dy anëtarë. Anëtarët e Komisionit duhet të jenë shtetas të Kosovës dhe duhet të kenë përvojë dhe njohuri për basketbollin dhe sportin kosovar. Kryetari i Komisionit duhet të ketë eksperiencë ligjore.

### **NENI 4 - Mbledhjet**

- 1.** Mbledhjet e Komisionit i thërret Sekretari i Përgjithshëm të FBK-së.
- 2.** Kryetari i Komisionit kryeson dhe udhëheqë me punën e Komisionit si dhe përcakton anëtarin i cili do të hartojë Vendimet e Komisionit. Vota e Kryetarit është e barabartë me atë të anëtarëve, dhe vendimet merren me shumicë votash.
- 3.** Në mbledhjet e Komisionit mund të jenë prezent edhe bashkëpunëtorë profesional brenda FBK-së (përfshirë këtu edhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK-



së) të cilëve u besohet kryerja e disa punëve në procedurën e vendosjes së drejtë, por vetëm në cilësinë këshill-dhënëse dhe pa të drejtë vote ose vendim marrjeje.

**4.** Në mbledhje mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruan Kryetari i Komisionit.

## **NENI 5 - Kompetenca**

**1.** Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit **vendos në shkallë të dytë** në rast të ankesave:

- 1.1.** Në vendimet e Komisionit të Garave apo Komesarit të Garave për Kategoritë e Reja;
- 1.2.** Në vendimet e Komisionit për Licencim;
- 1.3.** Në vendimet e Komisionit Disiplinor.

**2. Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit vendos** po ashtu për çështje statusore, ku përfshihen:

- 1.1.** Anëtarësia e klubeve, shkollave dhe shoqatave në FBK;
- 1.2.** Statusi i lojtarëve;
- 1.3.** Kontestet e transfereve të lojtarëve ose regjistrimit të lojtarëve;
- 1.4.** Kontestet kontraktuale klub - lojtar;
- 1.5.** Kontestet ndërmjet klubeve ose anëtarëve të FBK-së.

**3.** Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit mund të veprojë si organ arbitrazhi sportiv brenda FBK-së, në rastet kur kompetenca e tij është paraparë me aktet normative të FBK-së ose me marrëveshje ndërmjet palëve.

## **NENI 6 - Parashtrimi i Ankesës**

**1.** Ankesa në Vendimet e Komisioneve nga neni 5 i kësaj Rregulloreje parashtrohet me shkrim (formulari gjendet në ueb-faqen e FBK-së) dhe përmban, ndër të tjera:

- 1.1.** Emërtimin e personit që ankohet;
- 1.2.** Bazën juridike të ankimit;
- 1.3.** Faktet në të cilat mbështetet ankesa (provat materiale); dhe
- 1.4.** Saktësimin se i drejtohet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së.



- 2.** Ankesa parashtrohet brenda afateve të përcaktuara me aktet përkatëse normative të FBK-së, varësisht nga natyra e rastit.
- 3.** Pas pranimit të ankesës, KAA mund t'ia dërgojë ankesën palës tjetër ose të interesuar për përgjigje, duke caktuar afat të arsyeshëm për paraqitjen e përgjigjes.
- 4.** Parashtrimi i ankesës nuk ka efekt pezullues, përveç nëse parashihet ndryshe me akt tjetër normativ të FBK-së ose nëse Komisioni, me vendim të veçantë, vendos ndryshe.

## **NENI 7 - Taksa**

- 1.** Pala e cila ankohet, duhet ta paguaj taksën e caktuar me këtë rregullore, në ditën e paraqitjes së ankesës, dhe atë:
  - 1.1.** Për ankesën kundër vendimeve të Komisionit të Garave të FBK-së shumën prej 500 €;
  - 1.2.** Për ankesën kundër vendimeve të Komisarit të Garave për Kategoritë e Reja shumën prej 150 €;
  - 1.3.** Për ankesën kundër vendimeve të Komisionit për Licencim shumën prej 300 €;
  - 1.4.** Për ankesën kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor shumën prej 300 €.
- 2.** Në qoftë se ankesa aprovohet (përfshirë aprovimin e pjeshëm), shuma e taksës së paguar i kthehet ankuesit.

## **NENI 8 - Përfaqësimi para Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit**

- 1.** Klubet të cilat parashtrojnë ankesë, munden që në procedurë të përfaqësohen edhe nga personat e autorizuar, të cilët nuk janë përfaqësues zyrtar të klubeve.
- 2.** Të drejtën nga paragrafi i këtij neni e kanë edhe personat e tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen në Komisionin e Ankesave dhe Arbitrazhit.



## NENI 9 - Vendimet e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit

1. Komisioni duhet të bie vendim, në afatet e përcaktuara në Propozicionet e Garave, Rregulloren Disiplinore, apo në aktet tjera normative të FBK-së.
2. Në qoftë se nuk është prezent njëri anëtar i Komisionit, ai mund të deklarohet me shkrim, në lidhje me ankesën nëpërmjet postës elektronike.
3. Gjatë trajtimit të lëndës, **Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit mund të vendosë të:**
  - 3.1. **Hedh poshtë si të pa-lejueshme ankesën** - në rast se lënda është dorëzuar jashtë afateve, nuk është bërë pagesa sipas nenit 7, është dorëzuar nga personat e pa autorizuar ose nuk përbën lëndë për trajtim të ankesës apo arbitrazh;
  - 3.2. **Refuzohet** ankesa - rrjedhimisht të vërtetohet vendimi i shkallës së parë;
  - 3.3. **Aprovohet** (në tërësi ose pjesërisht) ankesa dhe të dërgohet në **rishqyrtim** nga shkalla e parë;
  - 3.4. **Aprovohet** (në tërësi ose pjesërisht) ankesa dhe **anulohet** vendimi i shkallës së parë;
  - 3.5. **Aprovohet** (në tërësi ose pjesërisht) ankesa dhe **ndryshohet** vendimi i shkallës së parë.
4. Vendimi i Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit duhet të përmbajë të paktën:
  - 4.1. Emrin e plotë të lëndës;
  - 4.2. Datën e vendimit;
  - 4.3. Përbërjen e Komisionit;
  - 4.4. Vendimin;
  - 4.5. Përshkrimin e procesit të trajtimit të lëndës;
  - 4.6. Arsyetimin;
  - 4.7. Këshillën Juridike.
5. Sipas nevojës dhe lëndës, Komisionit i Ankesave dhe Arbitrazhit mund të rekomandojë organet e tjera të FBK-së ose shërbimin administrativ të FBK-së, përfshirë këtu rekomandime rreth akteve normative dhe harmonizimit të tyre.
6. Vendimi i përcillet të dënuarit; klubit të tij/saj (nëse është dënuar lojtari/ja apo anëtar i klubit); paraqitësit të kërkesës/ankesës, anëtarëve të Komisionit



të Ankesave dhe Arbitrazhit dhe anëtarëve të organit të cilit i është sfiduar vendimi; dhe FIBA-s në rast se është shqiptuar dënim kohor për ndalesë loje apo kryerje të detyrës ose dënimi i ndalesës së përhershme për lojë ose kryerje të detyrës. Vendimi mund të përcillet edhe palëve të tjera me interes, sipas rastit.

**7.** Gabimet tipografike, numerike ose gabimet e tjera të dukshme në vendim mund të korrigojnë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të pjesëmarrësve në procedurë dhe më pas t'u komunikohen të gjithë palëve/pjesëmarrësve me shkrim.

**8.** Vendimet e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit janë publike dhe të njëjtat publikohen në faqen zyrtare të FBK-së. Përrjashtimisht, në raste të veçanta palët mund të paraqesin kërkesë për mospublikimin e vendimit, ose në rastet kur publikimi mund të cenojë të dhënat personale, interesat e të miturve ose integritetin e procedurës, në të cilin rast Komisioni mund të vendosë për publikim të pjesshëm ose anonimizim.

## **NENI 10 - Parimet themelore**

**1.** Komisioni gjatë punës së vet, duhet të vendos në bazë të parimit të çmuarjes së lirë të provave, akteve normative të FBK-së dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

**2.** Komisioni vendos në shkallë të dytë kryesisht mbi bazën e shkresave të lëndës dhe vendimit të ankimuar, duke garantuar palëve të drejtën për paraqitjen e pretendimeve dhe argumenteve të tyre juridike. KAA ka të drejtë, sipas rastit, të thërrasë seanca me palët.

**3.** Provat e reja pranohen vetëm nëse pala provon se ato nuk kanë mundur të paraqiten në shkallën e parë pa fajin e saj ose nëse administrimi i tyre është i domosdoshëm për garantimin e një procesi të rregullt dhe të drejtë.

**4.** Anëtarët e Komisionit janë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksionit të tyre dhe nuk mund të marrin pjesë në mbledhje në rast se ka konflikt interesi apo nëse është palë e dëmtuar. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit ose rrethanave që mund të vënë në dyshim paanshmërinë e tyre,



anëtari i Komisionit është i obliguar të vetë-përrjashtohet nga shqyrtimi i lëndës.

**5.** Anëtarët e Komisionit obligohen të respektojnë parimin e konfidencialitetit.

### **NENI 11 - Finalizimi i Vendimeve**

**1.** Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit gjatë marrjes së vendimeve duhet të përdorë vulën e FBK-së dhe vendimi duhet nënshkruar nga të tre anëtarët e Komisionit (mjafton edhe nënshkrimi elektronik apo i skanuar).

**2.** Vendimet e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit janë të detyrueshme dhe ekzekutohen menjëherë. Organet dhe anëtarët e FBK-së janë të obliguar t'i zbatojnë vendimet pa vonesë. Moszbatimi i vendimit përbën shkelje disiplinore.

### **NENI 12 - Këshilla Juridike**

Vendimet e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit kanë të drejtë të ankesës në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv.

### **NENI 13 - Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i FBK-së.

## **KUVENDI I FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS**

Kryetari

Arben **FETAHU**

**Prishtinë, 23.03.2026**

